



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AVOKATI I POPULLIT



100 Vjet Pavarësi

**Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit
gjatë vitit 2012 për të drejtat e personave LGBT**

23 Gusht 2012

I.Hyrje

Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve e Transgjinorëve në Shqipëri, duhet të gëzojë të drejta e liri në mënyrë të barabartë me të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Të drejtat e njeriut janë universale dhe zbatohen për të gjithë individët, dhe çdo vend duhet të garantojë dinjitet të barabartë për të gjithë qëniet njerëzore pa diskriminim për shkak seksi, race, ngjyre, feje, origjine kombëtare ose sociale.

Shumë njerëz janë të stigmatizuar, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor të tyre, dhe nuk mund të gëzojnë plotësisht të drejtat universale të njeriut. Disa prej tyre janë viktime të krimit të urrejtjes dhe nuk merren në mbrojtje, kur sulmohen në rrugë nga qytetarët e tjerë, ndërsa disa organizatave që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e tyre, ju është refuzuar regjistrimi, ose ju është vënë ne pikepyetje e drejta e tubimit paqësor. Zhvillimet e kohëve të fundit në shumë vende të Europës, por jo vetëm, tregojnë se politikanët, autoritetet shtetërore përgjegjëse, por edhe vetë opinioni publik, kanë mbajtur qëndrime të forta kundër homofobisë dhe shprehjeve transfobike, diskriminuese dhe dhunës ndaj personave të komunitetit LGBT.

Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë personave që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBT. Në këtë kontekst, prej disa muajsh, institucioni i Avokatit të Popullit po monitoron në vazhdimësi respektimin e të drejtave dhe lirive të personave LGBT në Shqipëri, apo masat që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore përgjegjëse, për garantimin e plotë të tyre.

Në Raport Progresin e BE për Shqipërinë për vitin 2011, është tërhequr vëmëndja mbi një serë çështjesh dhe problematikash që ka shoqëria shqiptare në trajtimin e komunitetit LGBT. Në raport theksohet se “...janë raportuar disa raste dhune dhe keqtrajtimi që kanë vënë në shënjestër persona të komunitetit transeksual, si dhe homofobia vazhdon të jetë gjerësisht e përhapur, madje edhe në radhët e zyrtarëve të shërbimit publik.”

Parashikimi në legjislacionin shqiptar i të drejtave dhe lirive themelore për

komunitetin LGBT, si dhe garantimi i zbatimit të tyre në praktikë, janë tepër të rëndësishme dhe për këtë arsye ato janë përfshirë brenda Rekomandimit 11 të BE për Shqipërinë “Liritë dhe të drejtat e njeriut”, dhe konkretisht në pjesën e mosdiskriminimit ndaj grupeve të ndryshme shoqërore.

Shqipëria, është në një moment të rëndësishëm të procesit të integritimit në Bashkimin Europian, në këtë kuadër institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se legjislacioni shqiptar duhet të përqaset me standardet më të mira ndërkombëtare, për të garantuar zbatimin e parimeve demokratike të shtetit të së drejtës, arritjen e barazisë midis shtetasve dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Orientimi seksual përshkruan një model/strukturë të qëndrueshme tërheqjeje emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim të tyre – kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja sekseve ose asnjërit prej sekseve dhe gjinive që i shoqërojnë ato.¹ Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë, orientimi seksual i referohet gjithashtu ndjenjës së “identitetit personal dhe shoqëror” të personit, pra në vetvete një relacioni social të ndryshëm të këtyre individëve nga personat e tjerë.

Identiteti gjinor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh femër ose mashkull, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik.² Lidhur me personat të cilët kanë një identitet gjinor të kundërt nga ai i dy gjinive të njohura (femër ose mashkull), vlerësojmë se dispozita është gjithpërfshirëse duke mospërcaktuar llojet e gjinive në mënyrë eksplicite, por duke lënë të hapur përfshirjen në këtë shkak edhe diskriminimin për shkak të një identiteti gjinor të ndryshëm nga ai klasik, apo i seksit biologjik. Duhet përmendur se së fundmi, personat transgjinorë nuk konsiderohen më si të sëmurë mendorë dhe në një hap historik Shoqata Amerikane e Psikiatrive njoftoi në fund të muajit korrik të vitit 2012 se e ndryshoi termin “Gender Identity Disorder” (C’rregullim i identitetit gjinor” term gjerësisht i përdorur si diagnozë në Manualin e Sëmundjeve Mendore (DSM).³

Nga ana tjetër në Shqipëri mungon akses i plotë i personave transgjinorë në shërbimin mjekësor, sidomos në rast se ata duan të kalojnë në procesin tranzitor të

¹ Përkufizim sipas raportuesit Gross për rezolutën e KiE “Për diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

² Përkufizim sipas raportuesit Gross për rezolutën e KiE “Për diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

³ për citim: <http://dot429.com/articles/1119>

shndërrimit të seksit të tyre biologjik në atë seks që u përshtatet me identitetin gjinor. Madje edhe në aspektin ligjor është ende e paqartë se si do të mund të ndryshohet në Gjëndjen Civile gjinia e një personi që ka mundur të kalojë me sukses në ndonjë vend të huaj fazën tranzitore të shndërrimit të gjinisë. Një problem ky që është vënë në dukje edhe nga përfaqësues të Këshillit të Europës që po asistojnë Ministrinë e Cështjeve Sociale në Shqipëri që të zbatojë rekomandimet e Këshillit të Europës për cështjet LGBT.

Shqipëria ka firmosur e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, të cilat në thelb kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti. Shqipëria ka hartuar edhe legjislacion të sajën kombëtar në një linjë me këto Konventa, por realiteti tregon se Konventat Ndërkombëtare apo Legjislacioni Kombëtar jo gjithnjë zbatohen.

Për tu zbatuar një Konvente Ndërkombëtare apo Ligj kombëtar, duhet që këto akte të njihen e të kuptohet nga ata që duhet t'i zbatojnë ato, si dhe nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut që vazhdimisht monitorojnë e ngrenë zërin në mbrojtje të këtyre të drejtave.

Shqipëria ka nënshkruar apo ratifikuar aktet ndërkombëtare si më poshtë vijon:

- Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit. Paris, 9 Dhjetor 1948
- Konventa ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. New York, 7 Mars 1966
- Amendim i nenit 8 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. New York, 15 Janar 1992
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. New York, 16 Dhjetor 1966
- Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. New York, 10 Dhjetor 2008
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. New York, 16 Dhjetor 1966
- Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. New York, 16 Dhjetor 1966
- Konventa mbi mos-zbatueshmërinë e kufizimeve ligjore për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. New York, 26 Nëntor 1968
- Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin dhe Dënimin e Krimit të Aparteidit. New York 30 Nëntor 1973

- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. New York 18 Dhjetor 1979

Deklarata e OKB-së mbi Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor e dhjetorit 2008, është hartuar me synimin e miratimit më tej në formën e një Rezolutive e cila në fakt nxiti një deklaratë kundërshtuese të Ligës Arabe. Të dyja deklaratat mbetën të hapura për nënshkrime dhe asnjëra prej tyre nuk është miratuar zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Deklarata e propozuar përfshin dënimin e dhunës, kërcënimit, diskriminimit, përjashtimit, stigmatizimit dhe paragjykimeve për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ajo gjithashtu përfshin dënimin e vrasjeve dhe ekzekutimeve, torturën, arrestin arbitrar dhe privimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore mbi ato baza. Deklarata e propozuar është vlerësuar si një moment i rëndësishëm për të drejtat e njeriut, duke thyer tabunë e heshtjes për të drejtat e LGBT në Kombet e Bashkuara. Kundërshtarët e saj e kritikuan atë si një përpjekje për të legjitimuar partnerët e të njëjtit seks ose martesën e tyre, adoptimit nga çifte të të njëjtës gjini, pedofilisë dhe zvogëlimit të lirisë të shprehjes së fesë kundër sjelljes homoseksuale.

Deklarata e Montrealit “Mbi të drejtat e njeriut të Lesbikëve, Gayve, Biseksualëve dhe Transeksualëve”. Ky është një dokument i miratuar në Montreal, Quebec, Kanada, më 29 korrik, 2006, nga Konferenca Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut të LGBT. Deklarata përcakton të drejtat dhe liritë që kanë të bëjnë me personat LGBT, të propozohen të jenë të garantuara në mënyrë universale. Ajo përfshin të gjitha aspektet e të Drejtave të Njeriut, nga garantimin i lirive themelore deri në parandalimin e diskriminimit të personave LGBT në shëndetësi, arsim dhe emigracion. Deklarata gjithashtu adreson çështjet e ndryshme që kërcënojnë promovimin global të të drejtave të LGBT⁴.

Sipas kësaj deklarate, shtetet duhet të ndërmerrin masa për edukatën shëndetësore, punësimin, të drejtat familjare për personat që i përkasin komunitetit LGBT. Kështu në arsim theksohet se kurikula duhet të përfshijë edhe të drejtat e njeriut për personat LGBT, shkollat duhet të ndërmarrin veprime kundër etiketimeve homofobe. Gjithashtu nëpërmjet kësaj deklarate i bëhet thirrje medias për të ndihmuar në thyerjen e stereotipeve dhe për të portretizuar njerëzit LGBT në njëmënyrë realiste. Në përmbajtjen e saj theksohet gjithashtu nevoja për aksesin

⁴ Marrë nga publikim i PINK Embassy/ LGBT Pro Albania në partneritet me COC Netherlands dhe CRCA Financuar nga Programi MATRA, Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Hollandës

në kujdesin shëndetësor në përgjithësi dhe për nevojat specifike të personave LGBT.

Nga ana tjetër në vendin tonë ka shumë pak informacion në lidhje me situatën e personave interseksualë. Ndonëse shumë prej aktivistëve LGBT në botë kanë përfshirë së fundmi edhe personat Interseksualë në paketën e lobimit të tyre (duke u shndërruar në LGBTI) në Shqipëri raportohet se personat i jo vetëm që ekzistojnë por janë të shumtë dhe mbahen fshehur nga familjarët e tyre.⁵

Nëpërmjet këtij raporti dëhurojmë t'ju paraqesim disa nga ndërhyrjet dhe veprimet që ka ndërmarrë gjatë vitit 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit, për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave LGBT.

II.Rekomandimi i Avokatit të Popullit lidhur me të drejtën për punësim dhe formim profesional

Institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit, nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike apo personave të tretë të lidhur me të. Në këtë kontekst, promovimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, ka të njëjtën vëmendje dhe rëndësi për Institucionin e Avokatit të Popullit, pavarësisht nëse individit është pjesë e një grupimi shoqëror në minorancë apo është pjesë e shumicës së shoqërisë.

Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve dhe Transgjinjorëve (LGBT) në Shqipëri, në bazë të legjisllacionit në fuqi, duhet të gëzojë të drejta dhe liri të barabarta me të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

Kushtetuta e vendos parimin e barazisë përpara ligjit, të lidhur ngushtë me parimin e mosdiskriminimit. Neni 18 i Kushtetutës shprehet dhe garanton parimin e barazisë të të gjithëve shtetasve para ligjit, pra pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore apo orientimit seksual që ata kanë.

Pra, mbështetur në përcaktimet e nenit 18 të Kushtetutës orientimi seksual apo identiteti gjinor i individëve mund të përbëjë shkak për të diferencuar dhe trajtuar

⁵ Për citim: nje shkrim i Shekullit që nuk gjendet më në arkivën e vet: <http://agjencia.info/2012/03/31/te-rritesh-mashkull-nje-dite-te-ndihesh-femer/>

në mënyrë të pabarabartë komunitetin LGBT, i cili për shkaqe të ndryshme ka apo mund të ketë një përbërje sociale të pavarur nga meritat e tyre, apo ka një identitet gjinor të ndryshëm nga ai i dy gjinive (femërore ose mashkullore).

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë, pavarësisht, përkatësisë gjinore, raciale, etnike, gjuhësore, bindjeve politike, fetare etj. E drejta për punë sipas këtij përcaktimi kushtetues përfshin si zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e formimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Parashikimi që bën neni 49 i Kushtetutës “...duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ai përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cënuar këtë të drejtë.”⁶

Gjithashtu, Kushtetuta në nenin 15 të saj angazhohet në mënyrë të veçantë për organet e pushtetit publik duke theksuar se: “Organet e pushtetit Publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti. Ndër aktet më të rëndësishme ndërkombëtare janë, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata e OKB mbi “Orientimin seksual dhe identitetin gjinor” nënshkruar nga vendi ynë më 18 dhjetor 2008, Protokollin nr. 12, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut “Për një ndalim të Përgjithshëm të Diskriminimit”, nënshkruar dhe ratifikuar në vitin 2010, Konventën nr.111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.

⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.20/2006

Sipas nenit 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare, dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Për më tepër, sipas pikes 2 të nenit 122 të Kushtetutës një marrëveshje ndërkombnëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Gjithashtu edhe për aktet ndërkombëtare të cilat janë të nënshkruara, shteti shqiptar në momentin e nënshkrimit të tyre ka marrë përsipër angazhimin që politikën dhe legjislacionin e tij në fushën përkatëse, duhet që nga momenti i nënshkrimit dhe deri në momentin e ratifikimit të jenë të përqasura, ose të përqasen me parashikimet e aktit të nënshkruar.

Shqipëria si shtet anëtar i Këshillit të Europës, duhet të marrë masa edhe për zbatimin e pikes V të rekomandimit të Rezolutës së Këshillit të Ministrave, të KiE, CM/REC(2010)5, ku trajtohen çështjet mbi punësimin, dhe në të cilin përcaktohet se *“Shtetet anëtare duhet të sigurojnë krijimin dhe zbatimin e masave të përshtatshme që ofrojnë mbrojtje efektive, kundër diskriminimit në sektorin publik apo privat, në bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor në punësim dhe profesion. Këto masa duhet të mbulojnë kushtet për qasje në punësim dhe zhvillim, largimet nga puna, pagesën dhe kushtet e tjera të punës, duke përfshirë parandalimin, luftën dhe dënimin e ngacmimeve dhe formave të tjera të viktimizimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet për të siguruar mbrojtje efektive të të drejtave për intimitetin e individëve transeksualë në kontekstin e punësimit, në aplikime të veçanta për punësim në lidhje me, për të shmangur çdo zbulimin e parëndësishme të historisë së tyre gjinore ose emrin e ish-të punëdhënësit dhe të punësuarit tjerë.”*

Shqipëria ka një legjislacion të brendshëm i cili rregullon në mënyrë të detajuar, si dhe plotëson në ato raste kur është e domosdoshme sipas Kushtetutës, çështje të cilat janë parashikuar në aktet ndërkombëtare lidhur me trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin.

Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, është një ligj kuadër që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Sipas nenit 1 të ligjit, shkaqet e diskriminimit mund të jenë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1, pra përfshirë edhe orientimin seksual. Sipas nenit 14 të këtij ligji, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ndër autoritete të tjera është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për punësim.

Parashikimi i mësipërm i ligjit është në përputhje me përcaktimet e nenit 199 të Kodit të Punës, sipas të cilit “Ministri i Punës është organi administrativ kompetent për përgatitjen e zbatimit të legjislacionit dhe politikës së punës.”

Ligji 10221/2010 është një ligj kuadër, i cili përcakton parimet, rregullat dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërkohë që aktet e tjera ligjore në fuqi, rregullojnë në mënyrë të posaçme mosdiskriminimin lidhur me të drejtën për punësim, të drejtën për arsimim, të drejtën për akses në të mirat dhe shërbimet etj.

Në kuptim të sa më sipër, rregullimi ligjor i posaçëm të cilit i referohemi për ndalimin e diskriminimit lidhur me të drejtën për punësim është ligji 7961/1995 “Kodi i Punës i RSH” (i ndryshuar).

Në nenin 9 të Kodit të Punës (i ndryshuar) parashikohet se ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit. Në pikën 2 të nenit 9 të Kodit të Punës, përcaktohet përkufizimi i diskriminimit si dhe shkaqet në bazë të të cilave mund të ndodhë diskriminimi si, raca, ngjyra, seksi, mosha, feja, bindjet politike, origjina kombëtare, origjina shoqërore, lidhjet familjare, të metat fizike ose mendore.

Në shkaqet e sipërcituara nga neni 9 i Kodit të Punës nuk përfshihet ndalimi i diskriminimit për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Megjithëse nuk ka kufizime ligjore të shprehura në mënyrë eksplicite për të drejtën për punësim në Kodin e Punës, në brendinë e tij nuk ka dispozita specifike që ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në fushën e punësimit dhe formimit profesional. Një boshllëk i tillë në legjislacionin e punës, mund të përbëjë shkak për të cënuar garantimin e të drejtës për punë të komunitetit LGBT, në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Pra në këtë rast, mangësia ligjore në legjislacionin e posaçëm mund të sjell probleme të zbatimit në praktikë të parimit të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit lidhur me ushtrimin e të drejtës së punës dhe për rrjedhojë mos-përmbushjen e qëllimeve të ligjit kundër diskriminimit, mosndëshkim të sjelljes diskriminuese dhe vendosjen e

Ministrisë përgjegjëse për zbatimin e ligjit në pamundësi për të arritur qëllimet dhe objektivat e ligjit.

Në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE, neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE, ka përcaktuar detyrimin e përgjithshëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Sipas këtij neni, palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit, zbatimin efektiv të tij, Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të bëhen gradualisht në përputhje me *acquis* e Komunitetit, si dhe do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet siç duhet.

Në paragrafin 3 të këtij neni të marrëveshjes, përcaktohet se ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të shtrihet gradualisht në të gjitha elementet e *acquis* të Komunitetit. Gjatë fazës së parë siç përcaktohet në nenin 6 të MSA, përafrimi do të përqendrohet në elementët themelorë të *acquis* tregut të brendshëm, si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat intelektuale, industriale dhe tregtare të pronës, prokurimi publik, standardet dhe çertifikimi, shërbimet financiare, tokës dhe transportit detar - me theks të veçantë në sigurinë dhe standardet mjedisore si dhe aspektet sociale - ligji i shoqërive tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtjen e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësitë e barabarta.

Për më tepër, Komisioni Evropian në Opinionin e vitit 2010 për Shqipërinë, ka theksuar se ka filluar procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE në fushën e legjislacionit të punës, trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe anti-diskriminimit, por janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme, për një përputhshmëri të plotë lidhur me këto çështje.

Mbi sa më sipër, duke qenë se nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit Shqipëri-BE, por edhe nga Opinioni i Komisionit Evropian, zbatimi i parimit të trajtimit në mënyrë të barabartë në legjislacionin e punës, është vlerësuar si element themelor për përafrimin e legjislacionit, Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duhet të rrisë përpjekjet për ndërmarrjen e nismave ligjore të cilat synojnë përputhshmërinë e plotë me *acquis communautaire* të BE.

Mbi sa më sipër bazuar edhe në parashikimet e Direktivës 2000/78 EC “Për krijimin e një kornize të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”, vlerësojmë se në nenin 9 të Kodit të Punës duhet të shtohen në shkaqet për të cilat ndalohet diskriminimi edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor.

Në nenin 1 të Direktivës 2000/78 EC, parashikohet se qëllimi i saj është për të përcaktuar një kuadër të përgjithshëm për luftën kundër diskriminimit në bazë, të fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual sa i përket punësimit dhe profesion, me synimin që në shtetet anëtare të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë. Pra Direktiva kuadër, ka parashikuar në shkaqet e diskriminimit edhe orientimin seksual.

Për më tepër, me qëllim garantimin e zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, në nenin 10 të Direktivës parashikohet se “Shtetet Anëtare marrin masa të tilla që janë të nevojshme, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore, për të siguruar që personat të cilët e konsiderojnë veten të dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, të paraqesin para gjykatës apo organit tjetër kompetent faktet nga të cilat mund të supozohet se personi ka qenë direkt ose indirekt i diskriminuar, ndërkohë që i padituri (në këtë rast punëdhënësi) duhet të provojë se nuk ka kryer shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”.

Parashikimi në ligj në mënyrë eksplicite i palës që është e detyruar të provojë që nuk ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë (në këtë rast punëdhënësi), vlerësojmë se do të garantojë zbatimin e këtij parimi në praktikë, do të qartësoje procedurat e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar, si dhe do të ndihmojë në rivendosjen e të drejtës nga organet e pushtetit gjyqësor apo organet e tjera kompetente, në rastet kur ajo i cënohet personave që pretendojnë se janë diskriminuar (pavarësisht shkakut të diskriminimit).

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështje nga Avokati i Popullit u arrit në konkluzionin se, neni 9 i Kodit të Punës nuk garanton *trajtim të barabartë* të personave LGBT për ushtrimin e të drejtës për punësim dhe formim profesional. Ai nuk është në përputhje me parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, në të cilin parashikohet se: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit*”, si dhe të një serë akte ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga shteti Shqiptar, të cituara më lart, përfshirë edhe nenin 1 të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A, të 10 Dhjetorit 1948, në të cilën përcaktohet se: “*Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave*”.

Për të rivendosur në vend këtë të drejtë të personave LGBT, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës që thotë se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të*

njeriut nga administrata publike”; në nenin 24/a të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” që thotë se: “*Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve*”; dhe në nenin 199, pika 2, të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet se “Ministri i Punës është organi administrativ kompetent për përgatitjen e zbatimit e legjislacionit dhe politikës së punës, është rekomanduar:

1. Përfshirja në pikën 2, të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.

2. Përfshirja në fund të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin.

Në vijim të rekomandimit të dërguar Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, prej tij është kthyer përgjigje, sipas të cilës është pranuar propozimi i bërë nga Avokati i Popullit dhe në ndryshimet që do t’i bëhen Kodit të Punës do të parashikohen propozimet për ndryshim në nenin 9 të Kodit të Punës.

III.Rekomandimi i Avokatit të Popullit për plotësimin e Kodit Penal të RSH

Në kuadër të zbatimit të objektivave në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por edhe të angazhimeve në zbatim të 12 Rekomandimeve që Komisioni Europian ka vendosur në procesin e integritit, Avokati i Popullit ka ndërmarrë disa nisma për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të komunitetit LGBT. Mbi bazën e propozimeve të ardhura nga ky komunitet, por edhe të faktorit ndërkombëtar në vijim të plotësimit të Rekomandimit të 11 të Komisionit Europian, Avokati i Popullit ndërmori një studim krahasues të legjislacionit penal në lidhje me mbrojtjen që i garantohet anëtarëve të këtij komuniteti.

Në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal në vitin 2007, në nenin 50, i cili parashikon rrethanat rënduese, është shtuar gërma “j”, me këtë përmbajtje; “kryerja e veprës e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale”.

Nga studimi i legjislacionit penal të vendeve të tjera rezulton se ato kanë zhvilluar konceptin e të ashtuquajturit krim i urrejtjes, duke e parashikuar në Kodin Penal si vepër penale, ose si rrethanë rënduese.

Krimet e urrejtjes janë vepra penale që motivohen nga paragjykimet. Është pikërisht motivi ai ç'ka i dallon krimet e urrejtjes nga krimet e tjera. Më shumë sesa një përcaktim ligjor, termi "hate crimes" përshkruan një koncept të caktuar. Krimet e urrejtjes gjithmonë përmbajnë dy elemente: një vepër penale të kryer dhe një motiv paragjykues ose diskriminues.

Elementi i parë lidhet me kryerjen e një akti që përbën vepër penale të parashikuar në Kodin Penal. Në këtë rast, aktit penal do t'i referohemi si "vepra bazë." Në rastin e krimeve të urrejtjes lipset gjithmonë ekzistenca e një vepre penale bazë. Pa këtë vepër bazë, nuk kemi krim të urrejtjes.

Elementi i dytë i krimit të urrejtjes ka të bëjë me faktin se vepra penale kryhet me një motiv të veçantë që ne i referohemi si "paragjykim ose diskriminim." Është pikërisht ekzistenca e këtij motivi diskriminues që i dallon krimet e urrejtjes nga krimet e tjera. Kjo do të thotë se autori i krimit e zgjedh objektivin e krimit të tij për shkak të disa karakteristikave të caktuara që e venë atë në pozita mbrojtjeje.

Objektivi mund të përbëhet nga një, apo më shumë njerëz, ose mund të jetë edhe pronë apo objekt që i takon një grupi me karakteristika të përbashkëta. Karakteristikë e mbrojtur është ai tipar që është i përbashkët për një grup të tërë, si p.sh., raca, gjuha, feja, origjina etnike, kombësia, apo çdo faktor tjetër i përbashkët.

Krimet e urrejtjes dallohen nga krimet e zakonshme jo vetëm për shkak të motivit të autorit, por edhe për shkak të impaktit mbi viktimën. Autori e zgjedh viktimën nisur nga anëtarësia e tij apo e saj në një grup të caktuar. Kjo do të thotë se për të nuk ka rëndësi se cilin anëtar të grupit zgjedh: çdo anëtar është njësoj i rrezikuar. Në dallim nga të gjitha veprat e tjera penale, viktimat e urrejtjes përzgjidhen për atë çka përfaqësojnë dhe jo për atë që janë. Mesazhi që jepet në rastin e veprave të tilla synon jo vetëm viktimën, por edhe komunitetin ku ai/ajo bën pjesë. Për rrjedhojë, nganjëherë krimet e urrejtjes përshkruhen si krime simbolike.

Krimet e urrejtjes synojnë të intimidojnë viktimën dhe komunitetin ku ai/ajo bën pjesë nisur nga karakteristikat e tyre të përbashkëta. Të tilla krime i japin mesazhin viktimës dhe përmes tij/saj gjithë komunitetit se janë të padëshiruar duke përçarur te ata mohimin e së drejtës të tyre për pjesëmarrje të plotë në shoqëri. Përmes

viktimës, u tregohet anëtarëve të tjerë të komunitetit që kanë të njëjtat tipare se nuk janë si gjithë të tjerët dhe se fare mirë mund të jenë viktimë e radhës. Rrjedhimisht krimet e urrejtjes rrezikojnë kohezionin social dhe përçajnë komunitetet.

Në këtë kuptim paraqiten tre argumente kryesore për të pasur një dënim të shtuar për krimet e urrejtjes:

Së pari, vlera simbolike e ligjit mund të përdoret për të demonstruar kundërshtimin e shoqërisë ndaj krimeve që bazohen në diskriminim.

Së dyti, ligjet penale kriminalizojnë dëmin e shkaktuar. Krimet e urrejtjes kanë një impakt më të madh mbi viktimën se krimet e zakonshme dhe ndikojnë gjithashtu edhe te anëtarët e tjerë të së njëjtit grup. Dënimi i shtuar justifikohet me dëmin që i shkaktohet individit dhe komunitetit njëkohësisht.

Së treti, motivi i posaçëm e bën krimin më serioz sesa i njëjti krim, por pa motivin e diskriminimit. Për këtë arsye ligjet penale vendosin dënime më të ashpra për këto krime, bazuar jo vetëm në pasojën, por edhe në qëllimin kriminal.

Lidhur me legjislacionet nacionale, disa vende si, Mbretëria e Bashkuar apo Republika Çeke, kanë sanksionuar vepra penale specifike të cilat përfshijnë diskriminimin, ndërkohë që vende të tjera akoma nuk kanë vendosur parashikime të tilla.

Neni 196 (2) i Kodit Penal të Republikës Çeke, parashikon burg nga 6 muaj deri në tre vjet për “përdorimin e dhunës kundër një grupi qytetarësh apo një individi, apo kërcënimin e tyre me vdekje, dëmtimin e shëndetit apo shkaktimin e dëmeve të tjera serioze për shkak të bindjeve politike, kombësisë, racës, besimit, apo mungesës së tij.”

Seksionet 29-32 të Aktit të Mbretërisë së Bashkuar, për Krimet dhe Cënimet e Rendit Publik futën krimet e reja për sulmet “e rënda racore” dhe “krimet e rënda për shkak të besimit fetar”, dëmtimet kriminale, ngacmimet dhe krimet kundër rendit publik.

Një numër i madh shtetesh europiane parashikojnë rritje të masës së dënimit nëse veprat penale kryhen për motive që kanë lidhje me orientimin e ndryshëm seksual, duke e parashikuar këtë motiv si rrethanë rënduese gjenerike apo specifike.

Neni 30.6 i Kodit Penal të Andorës, parashikon forcimin e dënimeve për krime që kryhen për “motive racore dhe ksenofobike, apo për arsye që lidhen me ideologjinë, fenë, kombësinë, origjinën etnike, orientimin seksual, sëmundjet, si dhe aftësitë e kufizuara fizike ose mendore të viktimës.”

Nenet 33-42 të Ligjit Belg të 10 Majit 2007, parashikojnë se “urrejtja, përçmimi, apo armiqësia për një person për shkak të ngjyrës së lëkurës, racës, prejardhjes, origjinës etnike, seksit, orientimit seksual, besimit, bindjeve politike, gjuhës, aftësisë së kufizuar apo statusit social” përbëjnë rethana rënduese që mund të çojnë në dyfishimin e dënimit që parashikohet për krimet respektive si: përdhunimi, vrasja dhe dëmtimet e qëllimshme, mos-dhënia e ndihmës një personi në rrezik, dhunimi i lirisë personale, cënimi i pronës private, shpifja, zjarrvënia dhe shkatërrimi i pasurisë apo sendeve personale.

Nenet 132-77 të Kodit Penal Francez, parashikojnë si rrethanë rënduese dëmtimin “e nderit ose reputacionit të viktimës, ose të një grupi personash të cilëve ju përket viktima, për shkak të identitetit të tyre seksual.

Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit ka vlerësuar se do të ishte oportune që në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, në nenin 50, gërma “j”, të shtohet si rrethanë rënduese edhe kryerja e veprës, e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me orientimin seksual. Në këtë mënyrë duke sanksionuar si rrethanë rënduese gjenerike, kryerjen e veprës për shkak të orientimit seksual, çdo vepër që do të kryhet në bazë të këtij motivi do të ketë automatikisht një sanksion të shtuar.

Në këto rrethana dhe me qëllim plotësimin e këtij vakumi ligjor, bazuar në nenin 63/3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe nenin 24/a të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : “*Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkeljen të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë t’i rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e tyre, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, në fund të muajit korrik 2012:*

1. Plotësimin e nenit 50, gërma “j” të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke parashikuar edhe orientimin seksual si motiv që përbën rrethanë rënduese. Pra, në gërmën “j” të nenit 50 të Ligjit

nr.7895 datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas fjalës “gjininë” të shtohet shprehja “orientimi seksual”.

Ministria e Drejtësisë me shkresën e saj nr. 5161/1, datë 21.08.2012 lidhur me këtë rekomandim është shprehur se:

“Terminologjia e përdorur në shkronjën “j”, të nenit 50 të Kodit Penal është në përputhje me terminologjinë e përdorur në nenin 18, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë në rastin më të parë, të ndërmarrjes së iniciativës për rishikimin e Kodit Penal, do të marrë në analizë edhe rekomandimet e përgatitura nga ana juaj mbi këtë çështje, duke mbajtur në konsideratë parimet kushtetuese dhe zhvillimet në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.”

IV.Rekomandimi i Avokatit të Popullit për kurrikulat në shkolla dhe trajtimin e personave LGBT në sistemin arsimor

Duke ditur se lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qënë shekuj me rradhë dhe vazhdojnë të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut për këtë kategori personash. Këto të drejta fillojnë që nga e drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna, liria e shprehjes, punësimi, shëndeti, strehimi, mosdiskriminimi etj. Një e drejtë shumë e rëndësishme është dhe mbetet arsimi. Këtu përfshihet e drejta për arsim pa diskriminim për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Këtu përfshihet edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve për tu edukuar në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social ose forma të tjera denigruese të lidhura me orientimin seksual. Paaftësia për të trajtuar çështjet e orientimit seksual ose identitetit gjinor, mund të ketë pasoja të dëmshme për këtë kategori të shoqërisë. Shteti duhet ta trajtojë këtë çështje në mënyrë të respektueshme, duke ofruar të gjitha kushtet për hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Kjo referuar edhe shumë akteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare siç janë ato të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që prej vitit 1981, në lidhje me diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe rekomandimit nr. 211 të vitit 2007 të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, për “lirinë e organizimit dhe shprehjes për lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët”. Komisioneri për Mbrojtjen

e të Drejtave të Njeriut ka luajtur një rol të rëndësishëm për monitorimin e situatës së lesbikeve, homoseksualeve, biseksualeve dhe transeksualeve në shtetet anëtare në lidhje me diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. OSBE-ODHIR ka botuar kohët e fundit mjaft raporte dhe dokumenta që analizojnë aspekte të caktuara të diskriminimit, bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor në shtetet anëtare të OSBE-së. Asambleja e Përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2008, e mbështetur nga 66 shtete (Shqipëria renditet e para në listë) , ka bërë një deklaratë e cila dënon shkeljet e të drejtave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të tilla si vrasjet, tortura, arrestimet arbitrare, mohimi i të drejtave sociale dhe kulturore, shëndetësore etj.

E drejta e arsimit shprehet në nenin 2 të protokollit të Konventës Evropiane “Për të Drejtat e Fëmijës”. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve shprehet se, të drejtat e njeriut të adoleshentëve duhet të promovohen në mënyrë që ata të gëzojnë standartet më të larta të mundshme shëndetësore. Si pasojë shtetet duhet të garantojnë të drejtën e fëmijëve dhe të rinjëve për arsimim në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social ose forma të tjera të diskriminimit. Shtetet duhet të marrin masat e nevojshme për tu siguruar se mësuesit kujdestarë dhe stafi akademik të jenë në gjendje të zbulojnë, të analizojnë, të përgjigjen në mënyrë efektive dhe të luftojnë çdo mënyrë diskriminimi për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Ato duhet ta trajtojnë çështjen e orientimit seksual dhe të identitetit gjinor në mënyrë të respektueshme dhe objektive në kurrikulat, ose në orët e edukimit seksual dhe gjinor, dhe duhet të hartojnë programe fillestare dhe vazhduese trajnimi, si dhe të mbështetin dhe udhëzojnë mësuesit dhe të gjithë stafin arsimor për të trajtuar këto çështje në perspektivën e antidiskriminimit. E gjithë kjo ne funksion të metodave që nuk përmbajnë forma paragjykimi për përjashtimin social, diskriminimin dhe mohim të dinjitetit njerëzor, që realizohen mbi grupet e marginalizuara të tillë si personat me orientim jo heteroseksuale. Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se të gjithë aktorët e shoqërisë duhet të inkurajojnë aksesin e studentëve në informacionin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe miratimin e kodeve të sjelljes kundër qëndrimeve homofobike ose transfobike, apo forma të tjera të diskriminimit. Kjo duhet të realizohet duke prodhuar dhe shpërndarë tekste për stafin arsimor, duke inkurajuar organizimin e fushatave shkollore, aktivitete kulturore kundër homofobisë me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të këtij komuniteti. E gjithë kjo me qëllimin e rritjes së ndërgjegjësimit rreth çështjeve të diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor ndërmjet stafit akademik, nxënësve, studentëve dhe prindërve.

Për këtë qëllim duhet që metodat, kurrikulat dhe burimet arsimore duhet të shërbejnë për zgjerimin e të kuptuarit dhe respektimin e individëve të ndryshëm pavarësisht nga orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor, duke përfshirë edhe nevojat e vecanta të nxënësve, studentëve prindërve dhe antarëve të tjerë të familjeve të tyre.

Të gjitha sa më sipër, parashikohen në Konventën Evropiane Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Ndërkohë ne vlerësojmë se edhe shteti shqiptar është dhe duhet të vazhdojë angazhimin e nisur, për mbrojtjen e këtij komuniteti ku vlen të përmendet edhe miratimi i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ngritjen e strukturës të Komisionerit Antidiskriminim, si dhe tryeza dhe takime të mbështetura nga projekte dhe asistencë të vazhdueshme të Këshillit të Evropës në Shqipëri.

Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se ekziston një nevojë e fortë për të rishikuar programet dhe materialet mësimore jo vetëm në Shqipëri e theksuar kjo edhe në Rekomandimin 2010 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku rregullat mësimore të mos jenë të njëanshme, diskriminuese dhe denigruese, por në mbrojtje dhe mbështetje të komunitetit LGBT, në çdo vend ku ata jetojnë dhe organizohen. Në raportin social dhe ligjor mbi diskriminimin me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor të Këshillit të Evropës, i cili mbulon 47 vende anëtare, Shqipëria renditet në listën e vendeve që kanë shkallë të lartë të homofobisë, prandaj vlerësojmë se është detyrë e gjithë strukturave shtetërore, por jo vetëm e tyre, të ndihmojnë në përthithjen sa më të mirë të për zbutjen e këtij fenomeni.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka theksuar se do jetë gjithnjë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive edhe të kësaj kategorie të shoqërisë ashtu siç mbron interesat dhe të drejtat e kategorive të tjera në nevojë, duke qenë i hapur gjithashtu për çdo bashkëpunim institucional shtetëror dhe shoqëror i cili do sjellë mbrojtjen dhe respektimin denjësisht të identitetit gjinor të personave transeksualë.

Mbështetur në analizën mësipërme në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur verën shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

1. Përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të

sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social apo trajtim ç'njerëzor lidhur me orientimin seksual ose me identitetin gjinor.

2. Trajnimin e stafit akademik për moslejimin e cdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës i është përgjigjur rekomandimit tonë duke theksuar se: Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka propozuar që të parashikohen këto masa në Draft Planin Kombëtar të Veprimit për të drejtat e personave LGBT, që po koordinohet nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, masa të caktuara për përmirësimin dhe plotësimin e kurrikulave në shkolla si dhe për trajnimin e stafit akademik.

V. Trajtimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit i të drejtave të personave LGBT në tryeza pune, aktivitete të ndryshme dhe Media

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nëshkruar disa marrëveshje me organizatat të shoqërisë civile të cilat mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komunitetit LGBT. Disa nga organizatat me të cilat Avokati i Popullit ka nëshkruar marrëveshje bashkëpunimi janë: “Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri”, “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT”, “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT”, “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT”.

Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve është shprehur angazhimi i përbashkët i Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile për;

a. shkëmbimin e informacionit dhe monitorimin e problematikave që ka zbatimin e legjislacionit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

b.për përgatitjen e studimeve vlerësuese dhe të raporteve të veçanta mbi legjislacionin shqiptar dhe zbatimin e tij nga organet e administratës publike;

c. a. analizën e projektligjeve që i propozohen Kuvendit, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre, si dhe ndërmarrjen e nismave të përbashkëta legjislative për përmirësimin e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, nën dritën e standardeve ndërkombëtare;

d.trajtimin e rasteve të çanta të cilat paraqiten, si ankesa për veprime apo mosveprime të paligjshme të organeve të administratës publike, ndaj komunitetit LGBT.

e.për promovimin dhe sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për garantimin e të drejtave dhe lirive.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë pjesë e një takimi të organizuar në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për përgatitjen e një Plani Veprimi për të drejtat e personave LGBT. Në vijim të këtij takimi, në muajin maj 2012, i janë përcjellë Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mendimet tona për draftin e parë të përgatitur të këtij plani veprimi.

Në përgjithësi lidhur me ngritjen e grupit të punës dhe objektin e punës së tij, Institucioni i Avokatit të Popullit është shprehur grupi i punës i ngritur nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nuk mund të shprehet për zgjerimin e objektit të masave që duhet të parashikohen për modsikriminimin e komunitetit LGBT, në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Brendshëm, sipas nenit 14 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin *vetem në lidhje me të drejtën për punësim*. Në këtë kontekst, parashikimi në këtë plan i të gjitha masave që duhet të ndërmerren për mosdiskriminimin e komunitetit LGBT, me grupin e punës së ngritur nga Ministri i Punës, nga Institucioni i Avokatit të Popullit është vlerësuar se del jashtë përcaktimeve të sipërcituara të ligjit për mosdiskriminimin.

Ligji për mbrojtjen e diskriminimit nuk ka parashikuar në brendinë e tij një mekanizëm koordinues, por gjithsesi në dispozita të posaçme kur parashikon autoritetet shtetërore përgjegjëse për marrjen e masave në fusha të caktuara, krahas ministrave përgjegjës sipas fushave përkatëse, përcakton detyrime edhe për Këshillin e Ministrave. Në këtë kontekst, Avokatit të Popullit në shkresën e tij sugjeroi ngritjen e një grupi ndërinstytucional pune me urdhër të Kryeministrit, në të cilin të ketë anëtarë përfaqësues të të gjitha ministrave që në fushën e tyre të veprimtarisë trajtojnë çështje që shqetësojnë komunitetin LGBT, por të ketë gjithashtu të ftuar edhe përfaqësues të institucioneve kushtetuese (si Avokati i Popullit) apo edhe të institucioneve të pavarura. Sipas mendimit tonë, plani i masave i hartuar në këtë mënyrë, jo vetëm do të rrokë të gjithë problematikën që shqetëson komunitetin LGBT, por do të adresojë edhe masa të cilat janë gjithpërfshirëse për të gjitha fushat.

Pavaresisht formës që mund të ndiqet për miratimin e këtij Plani Veprimi, pra me një Vendim të Këshillit të Ministrave, Avokati i Popullit sugjeroi që përpara miratimit të tij, pra që në fazën e hartimit duhet të ketë një formalizim me një urdhër të Kryeministrit të grupit ndërinstytucional të punës, sipas formatit të

sipërcituar. Në këtë mënyrë përfaqësuesit e këtyre institucioneve do të merrnin përsipër përgjegjësitë për:

a.masat e nevojshme dhe të domosdoshme që duhet të parashikohen në të, por edhe për kostimin e tyre me buxhete të programuara dhe të parashikuara në buxhetet e tyre vjetore, si dhe

b.zbatimin e tyre bazuar në afatet e përcaktuara.

Në këtë mënyrë masat e parashikuara në Planin e Veprimit do të kenë edhe garancinë e zbatimit të tyre në të ardhmen.

Një tjetër problem që në shkresën e Avokatit të Popullit u sugjerua që të vlerësohej ishte parashikimi institucioneve kushtetuese apo edhe institucioneve të pavarura, për zbatimin e masave të caktuara. Ne mendojmë se në këtë plan këto institucione mund të ftohen si instucione që mund të kontribuojnë për zbatimin e tyre.

Mendojmë se në Planin e Veprimit duhet të shtohen edhe dy kollona te tjera, ato të treguesve apo indikatoreve që përcaktojnë realizimin e masave, si dhe për burimin e financimit të kostos së masës konkrete. Vlerësojmë se këto elemente janë tepër të rëndësishme, si edhe ai i kostimit apo i buxhetimi të masave, për të garantuar zbatimin e tyre.

Gjithashtu në përgjithësi lidhur me masat e parashikuara, ne Projektplanin e Veprimit ne kemi vlerësuar se ato janë të pamjaftueshme për realizimin e një sërë objektivash dhe politikash. Për këtë çështje Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë elektronike i janë përcjellë komente apo sugjerime për plotësime, për çdo objektiv apo masë komente konkrete.

Në vijim të kësaj shkrese nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nuk është marrë në konsideratë sugjerimi i dhënë nga ana jonë për formalizimin e grupit të punës me urdhër të Kryeministrit, në mënyrë që ai të ishte në përputhje me parashikimet e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, por me qëllim që ai të ishte sa me gjithëpërfshirës dhe i plotë, si përsa i përket institucioneve të përfshira në të, ashtu edhe për propozimet, masat dhe aktivitetet që do të parashikoheshin. Në mënyrë elektronike na është përcjellë një variant tjetër i ripunuar i Draft Planit të Masave, i cili përsëri, edhe pse ka bërë plotësime me masa konkrete, në përmbajtjen e tij ende mungojnë treguesit dhe indikatorët të cilët masin realizimin e një mase (p.sh. numri i personave të punësuar kur behet fjalë për punësimin e tyre, apo numrin e personave të trajtuar me shërbime, kur bëhet fjalë për trajtimin e tyre me shërbime etj), si dhe fondet buxhetore që janë të nevojshme për zbatimin e çdo mase apo aktiviteti.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka marre pjese ne aktivitetin e organizuar ne Vlore ne daten 16 maj, te organizuar nga “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT” Dhe “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT”, ne kuader te dites nderkombetare kunder homofobise dhe transfobise.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit, ka qenë bashkëorganizator me organizatat e shoqërisë civile, në aktivitetet e organizuara në datën 17 maj, dita ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë. Në këtë ditë u organizua edhe një “Festival i diversitetit”. Për herë të parë këtë vit dhe ndryshe nga çdo vit tjetër, një pjesë e këtij aktiviteti u zhvillua në një mjedis publik të hapur, pranë sheshit “Vëllezërit Frashëri”, duke nisur me një Konferencë për Shtyp në orën 10:00 e duke vazhduar me aktivitete të tjera.

Organizata të shoqërisë civile, institucionet kryesore në vend, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, si dhe qytetarë të thjeshtë kishin mundësinë të bashkoheshin me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë. Ky event, ndryshe nga paraqitjet mediatike, nuk ishte një *paradë gay*, apo diçka e ngjashme, por një manifestim i shoqërisë civile i cili artikuloi nevojat dhe problemet e komunitetit LGBT në një mjedis të hapur shoqëror.

Ky event, organizohej në bashkëpunim me Ambasaden PINK/LGBT “Pro Shqipëri”, me qëllim zhvillimin dhe avancimin e një debati për të drejtat e njeriut në përgjithësi, dhe atë të të drejtave të komunitetit LGBT në veçanti, si dhe për të kërkuar më shumë angazhim dhe përpjekje nga autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe publiku shqiptar, në avancimin dhe respektimin e të drejtave të këtij komuniteti në vend.

Gjithashtu, po në datën 17 Maj 2012, u organizua një fushatë ndërgjegjësimi/komunikimi, që vendosi theksin jo vetëm tek mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBT, por për përfshirjen e diversitetit si të tërë, me qëllim dërgimin e mesazheve të tolerancës, pranimit dhe paqes për të gjitha grupet sociale.

Gjatë “Festivalit të diversitetit”, u zhvillua edhe Panairi i Informacionit mbi Diversitetin, në të cilin një tendë ishte edhe e Avokatit të Popullit. Gjatë këtij Panairi, Institucioni i Avokatit të Popullit, Organizatat e shoqërisë civile, institucionet e tjera shtetërore, si dhe ato për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shpërndan informacione dhe broshura mbi aktivitetin, funksionet dhe kompetencat e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nxjerrë dy deklaratave për shtyp, si reagim ndaj deklaratave publike të një funksionari të lartë të qeverisë (z.Spahija), ndaj komunitetit LGBT. Nëpërmjet deklaratave publike është kërkuar që ky zyrtar I lartë të qeverisë shqiptare, të kërkojë ndjesë publike dhe të marrë përgjegjësitë që i takojnë për pozicionin shtetëror që ai mban, për fjalët fyese dhe denigruese, të ripërsëritura në drejtim të komunitetit LGBT. Gjithashtu është dënuar fuqishëm çdo deklaratë dhe shprehje e këtij formati, që nuk ka asgjë të përbashkët me frymën e tolerancës, bashkëjetesës dhe diversitetit, si vlera tradicionale të shoqërisë shqiptare. Përveç kesaj, në deklaratat për shtyp është theksuar se qëndrime të tilla përveçse çorientojnë dhe dizinformojnë shoqërinë shqiptare, çenojnë në mënyrë të hapur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara nga Kushtetuta, përfshirë këtu edhe lirinë e tubimeve paqësore.

Për më tepër nëpërmjet këtyre deklaratave, Avokatit i Popullit mendon se bëhet thirrje dhe nxitet urrejtja e një pjese të shoqërisë shqiptare ndaj një pjese tjetër, duke i mohuar kësaj të fundit, garantimin dhe mbrojtjen e lirive themelore të cilat i gëzojnë dhe pjesa tjetër e shoqërisë. Për shoqërinë shqiptare të gjithë janë të barabartë para ligjit, pra kushdo, pavarësisht përkatësisë në një grupim apo komunitet shoqëror, sado vogël qoftë ai, ka të drejta dhe liri të barabarta pa asnjë lloj diskriminimi.

Avokati i Popullit mendon se shoqëria shqiptare nuk ka nevojë për pasione të tilla homofobike, përkundrazi, ka ardhur koha që ajo të hapë një dialog dhe debat qytetar për të drejtat dhe liritë e këtij komuniteti, duke dhënë në këtë mënyrë mesazhin e një shoqërie të hapur dhe të përparuar, e cila e pranon diversitetin. Duke i konsideruar këtë mendësi, si krejtësisht të papranueshme, Avokati i Popullit i ka bërë apel çdo zyrtari shtetëror të çdo niveli, mbi papajtueshmërinë flagrante të këtyre deklaratave me procesin e integritit të Shqipërisë në BE, dhe të vlerave europiane që mbart ky proces, vlera të cilat përjashtojnë kategorikisht sjellje dhe mendësi të tilla.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i zhvilluar gjatë muajit maj ka qene edhe konferenca rajonale e organizuar dhe sponsorizuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA me temë “Ndal dhunës: Të drejtat e LGBT janë të drejta të njeriut”.

Në këtë konferencë morën pjesë perfaqësues të 17 vendeve të ndryshme të botës. Konferenca u hap me një përshëndetje të Sekretares amerikane të Shtetit znj.Hillari Klinton e cila theksoi se :

“Këtë muaj dhe çdo muaj tjetër konfirmojmë mbështetjen ndaj çdo qënie njereëzore. Mbetet shumë për tu bërë për respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT. Është e rëndësishme që ne ti mbështesin, të luftojmë dhe punojmë për të drejta të barabarta. Unë kam besim, ndaj këtë muaj iu uroj krenari dhe gezuar”.

Në panelin hyrës të Konferencës, përshëndeti edhe Avokati i Popullit, z.Totozani, i cili theksoi se ende ka shumë për të bërë në Shqipëri, për të drejtat e personave LGBT, në drejtim të ndalimit të dhunës dhe të gjuhës së urrejtjes ndaj tyre, mosdiskriminimit për punësim dhe formim profesional, ofrim shërbimesh shëndetësore dhe sociale etj.

Në Konferencë u evidentua se akoma sot, në 78 vende të botës homoseksualiteti konsiderohet vepër penale, ndaj për këtë arsye nga ndërhyrjet e shumë panelistëve gjatë konferencës u nënvizua nevoja e reformimit të legjislacionit dhe marrja e masave të përshtatshme për këtë çështje në këto vende.

Në përfundim të Konferencës u kërkua që në çdo rast të shmanget gjuha e urrejtjes ndaj personave LGBT dhe të bëhen praktike procedurat administrative kunder deklaratave publike që shprehin urrejtje dhe diskriminim. Gjithashtu u nënvizua se duhet të ketë një partnership ndërmjet OJF-ve dhe Qeverisë, si dhe të mos ketë ligje “copy paste”, por përshtatje të ligjit me situatën dhe shoqërinë aktuale shqiptare. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar martesës ose partneritetit për çiftet LGBT, me qëllim që të sigurohet barazia e tyre me çiftet heteroseksuale dhe perfitimet që ligji sjell, por gjithmonë duke i përshtatur ndërhyrjet në legjislacion me realitetin shqiptar, dhe jo thjesht kopjim të një prej modeleve të huaja “modelit Danez-Gjerman-Anglez”.

U sugjerua të shikohet mundësia për krijimin e nje qëndre kulturore për promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe krijimi i nje biblioteke për personat LGBT. Duke patur në konsideratë problemin *e keqtrajtimit të fëmijëve nga prindërit, u propozua që të ngrihet një qendër me psikologë ku të trajtohen prindërit e fëmijëve homoseksuale dhe anasjelltas. Konferenca vlerësoi se në disa vende shpesh ligji kundër dikriminimit dhe ligjet në këtë fushë nuk përcaktojnë çështjet LGBT dhe thjesht këto çështje përfshihen përmes frazës “etj”*. Për këtë arsye politikanët mendojnë se këtu përfshihen edhe çështjet LGBT, por në fakt duhet nje përcaktim i qartë për zbatimin dhe përdorimin me efektivitet të ligjit.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm i Konferencës ishte rishikimi i legjislacionit për “hate crime”, sepse nuk ekziston ne Kodin Penal të RSh asnjë përcaktim lidhur me këto krime.

Konferenca nënvizoi se një vëmëndje e posaçme i duhet kushtuar kurrikulave të trajnimit policor dhe të stafëve të institucioneve të tjera, që gjatë veprimtarisë së tyre merren me trajtimin e këtij grupi personash.

Këto ishin disa nga rekomandimet më të rëndësishme të Konferencës ndërkombëtare të organizuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit, ka qenë mjaft aktiv në media, si në mediat audio-vizive, po ashtu dhe në shtypin e shkruar, përsa i përket mbrojtjes dhe garantimit të lirive të komunitetit LGBT.

Avokati i Popullit ka mbështetur të drejtat dhe liritë e komunitetit LGBT në intervista televizive (intervistë me gazetaren Ilva Tare, emisioni Tonight, Ora-neës), në intervista dhe editorial në shtypin e shkruar (Totozani: LGBT në shkolla), në intervistën e dhënë për Balkanëeb dhe Gazeta Shqiptare 19 Qershor 2012, Disa përgjigje për pikëpyetjet mbi LGBT, editorial nga Avokati i Popullit në gazetën Panorama 19 Qershor 2012, Dita Kundër Urrejtjes, editorial në gazetën Shekulli, 18 Maj 2012 etj)

Më poshte po ju rëndisim një listë të plotë të titujve që janë pasqyruar në media lidhur me mbrojtjen dhe të drejtat e lirive të komunitetit të LGBT në Shqipëri:

- Totozani: LGBT në shkolla, Balkanëeb 19 Qershor 2012;
- Disa përgjigje për pikëpyetjet mbi LGBT, Panorama 19 Qershor 2012
- “Lëndë për komunitetin gay në kurrikulat shkollore”, Panorama 13 Qershor 2012
- Dita Kundër Urrejtjes, Shekulli 18 Maj 2012
- Totozani: Duhet politika për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit LGBT, Balkanëeb 17 Maj 2012
- Avokati i Popullit: Kundërshtimet ndaj gay-ve, antivlerë. S’hyjmë në BE me paragjykime, Tema 17 Maj 2012
- Totozani: Të pranojmë ndryshimin e tjetrit pa paragjykime, RTV Ora Neës 16 Maj 2012
- Deklaratat kundër paradës Gay, LGBT tryezë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, Balkanëeb 28 Mars 2012
- Totozani pret stafin e Ambasadës PINK/LGBT Pro Shqipëri, Balkanëeb 21 Mars 2012

VI.Rekomandime

Në përfundim të vlerësimeve të sipërpërmendura dhe të problematikave të konstatuara për komunitetin LGBT, gjatë veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën janar-korrik 2012, mendojmë se gjendja e respektimit të të drejtave dhe lirive të këtij komuniteti, ka nevojë për përmirësim.

Nga analiza dhe vlerësimet e sipërpërmendura rekomandojmë:

1.Përfundimin e një Plani Kombëtar Veprimi për Masat për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Avokati i Popullit sugjeron që ky plan të jetë gjithpërfshirës në drejtim të institucioneve që do ta hartojnë, por edhe zbatojnë atë, si dhe të jetë sa më i plotë në drejtim të aktiviteteve, masave, treguesve, indikatorëve dhe buxheteve që do të programohen për realizimin e çdo mase.

2.Ndryshimin e Kodit të Punës së RSH:

a.Përfshirjen në pikën 2, të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim edhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.

b. Përfshirja në fund të nenit 9 të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin. Paragrafi i formuluar duhet të jetë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, pra duke e vendosur barrën e provës mbi punëdhënësin.

3.Në vijim të plotësimit të rekomandimit të sipërcituar, duhet që autoritetet shtetërore përgjegjëse, Inspektorati Shtetëror i Punës të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave të ndryshuara, në mënyrë që të garantojë edhe zbatimin në praktikë të dispozitës, nga punëdhënësit publik apo privatë.

4. Ndryshimin e Kodit Penal të RSH, plotësimin e tij në nenin 50, gërma “j, duke parashikuar edhe orientimin seksual si motiv që përbën rrethanë rënduese. Pra, në gërmën “j” të nenit 50 të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas fjalës “gjininë” të shtohet shprehja “orientimi seksual”.

5.Përfshirjen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social apo trajtim ç’njëzëzor lidhur me orientimin seksual ose me identitetin gjinor.

6. Trajnimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i stafit akademik për moslejimin e cdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale.

Në përfundim dëshirojmë të theksojmë, që konkluzionet dhe rekomandimet e sipërcituara do të jenë objekt i vlerësimeve dhe analizave të mëtejshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile të cilë bashkëpunojnë me institucionin tonë.

Institucioni i Avokati të Popullit është i vetëdijshëm që çështjet e trajtuara në këtë raport, janë vetëm një pjesë e shqetësimeve dhe problemeve që kanë personat që i përkasin komunitetit LGBT. Në këtë kontekst, puna e institucionit tonë në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, por edhe me autoritetet shtetërore përgjegjëse, do të jetë për të synuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave LGBT, edhe në fusha apo për çështje të tjera.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligj, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara për komunitetin LGBT, në rekomandimin 11 të BE për Shqipërinë, duke dhënë edhe kontributin e tij lidhur me këto çështje.